



V E N D I M
K.P.P. 117/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.03.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Start 2000” shpk, në procedurën e prokurimit “Marrëveshje kuadër”, me Nr. Ref-36750-12-06-2017, me objekt: *“Ruajtja e godinës dhe e ambienteve rrethuese të godinës së institucionit me roje private për vitin 2018”*, me fond limit 3.046.008,6 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27.12.2017, nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshem të Kujdesit Shendetesor Tiranë.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Eurogjici Security” shpk.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Klaron” shpk.

Ankimues:

“Start 2000” sh.p.k
Rruga Budi, Nr.19,
Tiranë

“Eurogjici Security” sh.p.k
Rruga “Adem Jashari”, L.8, H.10, Ap.3
Tiranë

“Klaron” sh.p.k
Rruga “Artan Lenja”, Pallati Perseos nr. 1025, Shk1, Kati 2, Ap.5
Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë
Rruga “Sami Frashëri”, Nr. 8 ,
Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2 Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 07.12.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit me Nr. Ref-36750-12-06-2017, me objekt: *“Ruajtja e godinës dhe e ambienteve rrethuese të godinës së institucionit me roje private për vitin 2018”*, me fond limit 3.046.008,6 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27.12.2017, nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshem të Kujdesit Shendetesor Tiranë.

II.2. Në datën 08.01.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Toni Security” sh.p.k	2.114.460,00 lekë, skualifikuar
2. “Snajper Security” sh.p.k	2.121.868,58 lekë, skualifikuar
3. “Trezhnjeva” sh.p.k	2.404.438,20 lekë, skualifikuar
4. “Dea Security” sh.p.k	2.448.540,48 lekë, skualifikuar
5. “Arbana Sh.A” sh.p.k	2.839.863,24 lekë, skualifikuar
6. “Eurogjici Security” sh.p.k	2.880.528,00 lekë, skualifikuar
7. “Nazeri 2000” sh.p.k	2.880.635,88 lekë, kualifikuar
8. “Ales” sh.p.k	2.880.635,88 lekë, kualifikuar
9. “Firdeus Security” sh.p.k	2.880.635,88 lekë, skualifikuar
10. “Oktapus” sh.p.k	2.880.635,88 lekë, kualifikuar
11. “SSX” sh.p.k	2.880.635,88 lekë, kualifikuar
12. “International Security Albania” sh.p.k	2.880.635,88 lekë, kualifikuar
13. “Oktapus 1 Security” sh.p.k	2.880.635,88 lekë, kualifikuar
14. “Aulona Pol 1” sh.p.k	2.880.635,88 lekë, kualifikuar
15. “Klaron” sh.p.k	2.880.635,88 lekë, skualifikuar
16. “Start 2000” sh.p.k	2.880.635,91 lekë, skualifikuar

Operatori ekonomik ankimues “Start 2000” shpk, është njoftuar elektronikisht mbi skualifikimin e tij me arsyen se:

“Nga verifikimi i ofertës ekonomike rezulton se ka gabime aritmetike në lidhje me ofertën mujore dhe ofertën vjetore. Nga ana e KVO, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në zbatim të DST, është bërë korrigjim i gabimeve aritmetike dhe nëpërmjet postës elektronike të app.gov.al të datës 03.01.2018 është kërkuar pranimi i ndreqjes së këtyre gabimeve. Nga ana juaj nuk është kthyer përgjigje në lidhje me pranimin e korrigjimeve aritmetike.”

Operatori ekonomik ankimues “Eurogjici Security” shpk, është njoftuar mbi skualifikimin e tij me arsyen se:

“Oferta ekonomike është nën kosto ligjore. Gjithashtu, oferta është me gabime aritmetike, ku nga ana e KVO, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në zbatim të DST, është bërë korrigjim i gabimeve aritmetike dhe nëpërmjet postës elektronike të app.gov.al të datës 03.01.2018 është kërkuar pranimit i ndreqjes së këtyre gabimeve. Nga ana juaj, më datë 04.01.2018, është kthyer përgjigje ku nuk shpreheni në lidhje me pranimin e korrigjimeve aritmetike.”

Operatori ekonomik ankimues “Klaron” shpk, është njoftuar mbi skualifikimin e tij me arsyen se:

“Mos përmbushjen e kritereve të përcaktuara në Dokumentat e Tenderit në lidhje me: -Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me certifikatë regjistrimi si person i tatueshëm, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithëshme e Tatimeve, me numrin përkatës të identifikimit (NIPT). - Furnizime të mëparshme të së njëjtës natyrë në një kontratë me vlerë jo më të ulët se 40% e fondit limit të kontratës, (në një vlerë jo më të ulët se (1,218,403.44) lekë furnizimi të jetë i realizuar gjatë 3 viteve të fundit (2015, 2016, 2017) të aktivitetit të operatorit ekonomik. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë: Kur kontrata e së njëjtës natyrë është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate. OSE Kur kontrata e së njëjtës natyrë është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur kontratën e nënshkruar, me subjektin privat të shoqëruar me faturat përkatëse tatimore të shitjes që mbulojnë vlerën e kontratës. Nga ana juaj nuk plotësohen kriteret e kualifikimit pasi nuk keni paraqitur certifikatë regjistrimi si person i tatueshëm, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithëshme e Tatimeve, me numrin përkatës të identifikimit (NIPT) si dhe furnizime të mëparshme të së njëjtës natyrë në një kontratë janë me vlerë më të vogël se 40% e fondit limit të kontratës.”

II.3. Në datën 09.01.2018 operatori ekonomik ankimues “Start 2000” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke pretenduar si vijon:

“Autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), me datë 27.12.2017 zhvilloi procedurën e tenderit “Kërkesë për propozim”, me objekt: Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “Ruajtja e godinës dhe e ambienteve rrethuese të godinës së institucionit me roje private për vitin 2018”- Marrëveshje Kuadër- me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 12 muaj, me fond limit:

Fondi i Marrëveshjes Kuadër për 12 muaj: 3.046.008,60 lekë pa TVSH.

Fondi për një vendroje/një muaj: 50.766,81 lekë pa TVSH.

Operatori ynë paraqiti ofertën prej 2.880.635,91 lekë pa TVSH në vit.

Me datë 03.01.2018 në faqen elektronike të APP-së, autoriteti kontraktor ka dërguar mesazh me këtë përmbajtje:

“Oferta jonë ekonomike ka një gabim në vlerën 0,03 lekë.

Në mbështetje të DST vlera e korrigjuar e ofertës tuaj është 2.880.635,88 lekë dhe jo 2.880.635,91 lekë,” dhe ka kërkuar që të paraqitemi për të bërë korrigjimin brenda 24 orëve.

*Autoriteti kontraktor thekson se nga analiza e saj na rezulton se: 240.052,99 lekë në muaj*12muaj =2.880.635,66 lekë, ndërkohë që kemi një gabim në vlerën 0,03 lekë.*

Operatori ynë ekonomik, pasi analizoi edhe një herë ofertën e përgatitur, gjykoi se kjo ofertë është plotësisht e rregullt dhe ligjore dhe nuk korrigjohet.

Në datën 08.02.2018 në faqen elektronike të APP-së u bë njoftimi nga autoriteti kontraktor për statusin e ofertave dhe klasifikimin e tyre.

Oferta e operatorit tonë nuk është pranuar, duke u skualifikuar. Në arsyen e përdorur i qëndron gabimit që ka oferta jonë ekonomike prej 0.03 lekë.

Operatori ynë ekonomik, në përgatitjen e ofertës ekonomike ka zbatuar të gjitha detyrimet ligjore dhe më konkretisht veprimet aritmetike të kryera janë:

Paga për një roje në muaj, shumëzuar me koeficientin 4.91, shumëzuar me periudhën prej 12 muaj.

Atëherë kemi: $48.890,63 \text{ lekë} \times 4,91 \text{ roje} \times 12 \text{ muaj} = 2.880.635,91 \text{ lekë}$, pa TVSH.

Theksojmë se kjo llogaritje është e saktë.

Veprimi që ka kryer autoriteti kontraktor, duke bërë veprime të ndara shumëzimi, ka nxjerrë diferencë të gabuar prej 0,03 lekë, është jo korrekte.

Kërkojmë të pezullohet kjo procedurë tenderimi, skualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë të renditur para nesh dhe me vlerë më të vogël, autoriteti kontraktor të pranojë ofertën tonë ekonomike, duke e kualifikuar atë.”

II.3.1. Në datën 18.01.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit nëpërmjet shkresës nr 130/1 prot., duke e refuzuar ankesën si më poshtë:

“Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (këtu e në vijim “Komisioni”), i ngritur me urdhër të Titullarit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (këtu e në vijim “Fondi”) nr. 23, datë 11.01.2018, mori në shqyrtim ankesën tuaj, në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Ruajtja e godinës dhe ambienteve rrethuese të godinës së institucionit me roje private për vitin 2018”, protokolluar pranë Fondit me nr. 130 prot., datë 10.01.2018.

Nga shqyrtimi i formularit të ankesës së paraqitur nga ana juaj konstatojmë se, shoqëria juaj kundërshton skualifikimin e bërë nga procedura e mësipërme e prokurimit, e shpallur për t’u zhvilluar nga ana e Fondit në datë 27.12.2017.

Duke qënë se procedura e mësipërme është hapur në datë 27.12.2017 dhe vlerësimi i ofertave të paraqitura në sistemin elektronik të Agjencisë së Prokurimit Publik nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ka përfunduar në datë 08.01.2018, Komisioni vendosi të marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga ana juaj pasi është depozituar në Fond brenda afateve ligjore të pëcaktuara në nenin 63/2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimti publik”, i ndryshuar, (këtu e në vijim “LPP”).

Duke ju referuar ankesës suaj konstatojmë se nga ana juaj kundërshtohet skualifikimi i bërë dhe është kërkuar që:

1. Autoriteti kontraktor të pranojë ofertën ekonomike, të paraqitur në këtë procedurë nga ana e operatorit ekonomik, pasi është plotësisht e rregullt dhe ligjore dhe nuk korrigjohet, duke e kualifikuar në këtë procedurë prokurimi.
2. Të skualifikojë operatorët ekonomikë të kualifikuar me një ofertë më të ulët ekonomike.

Në lidhje me pretendimin e parë Komisioni sqaron se, nga ana e Fondit është kryer përlllogaritja e ofertës ekonomike minimale për periudhën 12 mujore. Kjo përlllogaritje është kryer në zbatim të të gjitha detyrimeve ligjore të parashikuara në Dokumentat Standarde të Tenderit, nga ku janë

mbështetur edhe veprimet përkatëse aritmetike. Në përfundim të kësaj llogaritje, është konkluduar se shuma minimale për periudhën 12 mujore rezulton të jetë 2.880.635,88 lekë pa TVSH.

Mbështetur në këtë llogaritje, ka rezultuar se oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik “Start 2000” sh.p.k ka gabime aritmetike në lidhje me ofertën mujore dhe rrjedhimisht me ofertën vjetore të cilat nuk tejkalojnë 2% të vlerës.

Nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 66, pika 4 ku citohet shprehimisht: “Oferta e kualifikuar verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen me mënyrën e mëposhtme; Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet cmimit për njësi dhe cmimit në total, që del nga shumëzimi i cmimit të njësisë me sasinë, cmimi i njësisë mbizotëron dhe cmimi në total korrigjohet në bazë të tij. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se $\pm 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar”, janë bërë korrigjimet përkatëse të ofertës. Ndërkohë operatorit ekonomik “Start 2000” sh.p.k në datë 03.01.2018 i është kërkuar nëpërmjet sistemit elektronik pranimi i ndreqjes së gabimeve aritmetike të konstatuara nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave, duke i dhënë këtij të fundit një afat prej 24 orësh për të kthyer një përgjigje në lidhje me pranimin e tyre.

Nga ana e operatorit ekonomik në fjalë, brenda afatit kohor të parashikuar, nuk është kthyer asnjë përgjigje mbi pranimin e modifikimit të gabimeve aritmetike të kryera nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Në pikën 4 të nenit të mësipërm parashikohet se “Nëse pas kërkesës së komisionit të vlerësimit të ofertave, ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë”.

Pra duke qënë se korrigjimi i propozuar nuk është pranuar, mbështetur në përcaktimin e mësipërm ligjor kjo ofertë refuzohet nga ana e KVO-së.

Përsa më sipër, ankesa e parashtruar nga ana juaj për këtë pikë, nuk qëndron.

Në lidhje me pretendimin e dytë Komisioni sqaron se, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, sic u përmend më sipër, në zbatim të të gjitha detyrimeve ligjore të parashikuara në Dokumentat Standarde të Tenderit, komisioni i vlerësimit të ofertave ka kryer përlllogaritjet e ofertës ekonomike minimale për periudhën 12 mujore. Është konkluduar se shuma minimale për periudhën 12 mujore rezulton të jetë 2.880.635,88 lekë pa TVSH. Në kualifikimin e operatorëve ekonomikë komisioni i vlerësimit të ofertave është mbështetur në këtë kosto, duke marrë parasysh gjithashtu plotësimin e të gjitha kriterëve ligjore dhe teknike të parashikuara në DST. Përsa më sipër ankesa e parashtruar nga ana juaj për këtë pikë, nuk qëndron.”

II.3.2. Në datën 24.01.2018 operatori ekonomik “Start 2000” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor. Gjithashtu pretendon se shoqëritë “Nazeri 2000” sh.p.k, “Ales” sh.p.k, “Oktapus” sh.p.k, “SSX” sh.p.k, “International Security Albania” sh.p.k, “Oktapus 1 Security” sh.p.k dhe “Aulona Pol 1” sh.p.k kanë bërë veprime aritmetike të njëjta me AK-në, duke ndarë zinxhirin aritmetik të shumëzimit, pagë për roje x koeficient dhe më pas shumëzimin e shumës së dalë me dy shifra pas presjes dhjetore me periudhën prej 12 muaj.

II.3.3. Në datën 08.02.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 100/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 130/3 prot., datë 01.02.2018 me objekt: *“Informacion i detajuar lidhur me procedurën e prokurimit me objekt: “Ruajtja e godinës dhe ambienteve rrethuese të godinës së institucionit me roje private për vitin 2018”, bashkëngjitur dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.*

II.4. Në datën 11.01.2018 operatori ekonomik ankimues “Eurogjici Security” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij, si vijon:

“[...]Shoqëria jonë ka përllogaritur në mënyrë të saktë të gjitha zërat e ofertës ekonomike si dhe ka respektuar të gjitha detyrimet ligjore në fuqi për pagën bazë, shtesat mbi pagë, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe ka përllogaritur sipas afatit të publikuar nga AK-ja në DST. Shoqëria jonë ka paraqitur formularin e ofertës së bashku me preventivin dhe analizën e detajuar të kostos. KVO-ja ka detyrimin të shqyrtojë dhe të vlerësojë ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato aferta që përmbushin të gjitha kërkesat ligjore, administrative e kualifikuese dhe/ose që nuk janë me cmim anomalisht të ulët. Në lidhje me “...korrigjim i gabimeve aritmetike dhe nëpërmjet postës elektronike të app.gov.al të datës 03.01.2018 është kërkuar pranimi i ndreqjes së këtyre gabimeve”, shoqëria jonë ka kthyer përgjigje, duke referuar bazën ligjore dhe konkretisht nenin 66, pika 4 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 dhe ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku ka shpjeguar se në lidhje me ofertën, presjet dhjetore nuk janë të ndaluara me ligj, nëse i referohemi dhe rekomandimeve përkatëse [...]”.

II.4.1. Në datën 19.01.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit nëpërmjet shkresës nr 200/1 prot., duke e refuzuar ankesën si vijon:

“[...] Në lidhje me pretendimin tuaj konstatohet se nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është kryer pëllogaritja e ofertës ekonomike minimale për periudhën 12 mujore. Kjo përllogaritje është kryer në zbatim të të gjitha detyrimeve ligjore të përcaktuara në DST, ku janë mbështetur edhe veprimet përkatëse aritmetike. Në përfundim të kësaj llogaritje është konkluduar se shuma minimale për periudhën 12 mujore rezulton 2.880.635,88 lekë pa TVSH. Për pasojë nga ana e kësaj shoqërie nuk është respektuar kosto minimale ligjore e parashikuar nga autoriteti kontraktor.

Mbështetur në këtë llogaritje, ka rezultuar se oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k ka gabime aritmetike në lidhje me ofertën mujore dhe rrjedhimisht me ofertën vjetore të cilat nuk kanë tejkaluar 2% të vlerës së ofertës. Nga KVO-ja janë bërë korrigjimet përkatëse të ofertës. Ndërkohë operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k në datë 03.01.2018 i është kërkuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve pranimi i ndreqjes së gabimeve aritmetike të konstatuara nga ana e KVO-së, duke i dhënë këtij të fundit një afat prej 24 orësh, për të kthyer një përgjigje në lidhje me pranimin e tyre.

Në datë 04.01.2018 nga ana e shoqërisë “Eurogjici Security” sh.p.k është dërguar përgjigje dhe është shprehur mbi pranimin e korrigjimit të ofertës dhe nuk është pranuar korrigjimi i gabimeve aritmetike të konstatuara nga KVO me argumentimin se janë respektuar të gjitha detyrimet ligjore ... dhe ka bërë përllogaritjet sipas afatit të publikuar nga AK-ja në DST.

Në nenin 66, pika 4 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin erregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Nëse pas kërkesës së komisionit të vlerësimit të ofertave, ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një i tillë”.

Sqarojmë gjithashtu se nga ana e komisionit të prokurimit publik nuk është deklaruar në asnjë moment fakti se presjet dhjetore janë të ndaluara me ligj.

Pra në momentin kur nga ana juaj nuk është pranuar korrigjimi i propozuar, mbështetur në përcaktimin e mësipërm ligjor, oferta do të refuzohet.”

II.4.2. Në datën 26.01.2018 operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.4.3. Në datën 12.02.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 127/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 200/3 prot., datë 07.02.2018 me objekt: “Kthim përgjigje mbi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë “Eurogjici Security” sh.p.k dhe “Klaron” sh.p.k lidhur me procedurën e prokurimit me objekt: “Ruajtja e godinës dhe ambienteve rrethuese të godinës së institucionit me roje private për vitin 2018”.

II.5. Në datën 11.01.2018 operatori ekonomik ankimes “Klaron” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor. Në ankesë pretendohet skualifikimi i tij i padrejtë dhe konkretisht:

“[...] Argumentat e KVO-së për skualifikimin e ofertës sonë janë krejtësisht të gabuara dhe subjektive.

Arsyeja pse nuk kemi paraqitur NIPT është totalisht qesharake pasi, si fillim duam t’ju informojmë se kjo kërkesë është hequr me vendim qeverie, por ajo që është më kryesorja është se ne kemi paraqitur ekstraktin e rregjistrimit të thjeshtë tregtar dhe atij historik po ashtu dhe 3 vërtetimet nga tatimet, cka dëshmon se shoqëria jonë ka një aktivitet aktiv dhe të qëndrueshëm.

Arsyeja e dytë se nuk kemi paraqitur kontrata të ngjashme në masën 40% nuk qëndron, pasi ne kemi paraqitur kontrata me institucione shtetërore dhe fatura tatimore të shitjes së shërbimit me subjekte private në përputhje të plotë me kërkesën e AK-së dhe rregullat e prokurimit publik.”

II.5.1. Në datën 24.01.2018, nëpërmjet shkresës nr. 220/1 protokoli datë 19.01.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankesës si vijon:

“[...] Në lidhje me pretendimin e parë sqarojmë se nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është bërë vlerësimi i formularit të ofertës si dhe i të gjithë dokumentacionit teknik dhe ligjor të paraqitur nga ana juaj në këtë procedurë prokurimi.

Gjatë këtij vlerësimi është konstatuar se nuk është paraqitur certifikata e rregjistrimit si person i tatueshëm, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me numrin përkatës të identifikimit (NIPT).

Sqarojmë se në DST, kriteret e vecanta për kualifikim, pika 2.1 Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë, ofertuesi duhet të tregojë se nga ana ligjore është në gjendje të realizojë objektin e

prokurimit dhe për këtë “Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me certifikatë rregjistrimi si person i tatueshëm, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me numrin përkatës të identifikimit (NIPT)”.

Për pasojë kriteri i mësipërm për kualifikim nuk është plotësuar nga ana e operatorit tuaj ekonomik. Gjithashtu është konstatuar se në DST, Kriteret e vecanta për kualifikim, pika 2.3, Kapaciteti teknik, është kërkuar:

1. Furnizime të mëparshme të së njëjtës natyrë në një kontratë me vlerë jo më të ulët se 40% e fondit limit të kontratës, (në një vlerë jo më të ulët se 1.218.403,44 lekë). Furnizimi të jetë i realizuar gjatë 3 viteve të fundit (2015,2016,2017) të aktivitetit të operatorit ekonomik.

Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a. Kur kontrata e së njëjtës natyrë është realizuar me institucione shtetërore , operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate.

Ose

b. Kur kontrata e së njëjtës natyrë është realizuar me subjekte private, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me subjektin privat të shoqëruar me faturat përkatëse tatimore të shitjes që mbulojnë vlerën e kontratës.

Gjatë vlerësimit të kontratave të paraqitura nga subjekti ankimes, konstatohet se këto kontrata nuk përmbushin vlerë prej 40% të fondit limit të kontratës sic është specifikuar në kriterin e mësipërm për kualifikim.

Duhet theksuar se faturat tatimore të shitjes së shërbimit me subjektet private nuk i janë bashkëlidhur kontratat përkatëse sic është kërkuar specifikisht në kriterin e mësipërm për kualifikim dhe për pasojë nuk mund të merren parasysh në përlllogaritjen e vlerës prej 40% të fondit limit të kontratës. [...]

Sqarojme se në momentin kur keto kritere për kualifikim nuk janë ankimuar, në përputhje me procedurat ligjore në fuqi, konsiderohen si të mirëqëna nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe duhen plotësuar si të tilla.”

II.5.2. Në datën 29.01.2018 ankimesi ka paraqitur ankesë pranë Komsionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.5.3. Në datën 12.02.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 127/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 200/3 prot., datë 07.02.2018 me objekt: “Kthim përgjigje mbi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë “Eurogjici Security” sh.p.k dhe “Klaron” sh.p.k lidhur me procedurën e prokurimit me objekt: “Ruajtja e godinës dhe ambienteve rrethuese të godinës së institucionit me roje private për vitin 2018”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Start 2000” sh.p.k sipas të cilës, “[...] Nga verifikimi i ofertës ekonomike rezulton se ka gabime aritmetike në lidhje me ofertën mujore dhe ofertën vjetore. Nga ana e KVO, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në zbatim të DST, është bërë korrigjim i gabimeve aritmetike dhe nëpërmjet postës elektronike të app.gov.al të datës 03.01.2018 është kërkuar pranimi i ndreqjes së këtyre gabimeve. Nga ana juaj nuk është kthyer përgjigje në lidhje me pranimin e korrigjimeve aritmetike”, si dhe arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k se: “oferta është me gabime aritmetike, ku nga ana e KVO, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në zbatim të DST, është bërë korrigjim i gabimeve aritmetike dhe nëpërmjet postës elektronike të app.gov.al të datës 03.01.2018 është kërkuar pranimi i ndreqjes së këtyre gabimeve. Nga ana juaj, më datë 04.01.2018, është kthyer përgjigje ku nuk shpreheni në lidhje me pranimin e korrigjimeve aritmetike”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Sipas ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Start 2000” sh.p.k dhe “Eurogjici Security” sh.p.k, rezulton se nga ana e tyre nuk është pranuar korrigjimi i gabimeve aritmetike.

III.1.2. Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë në fjalë dhe konstatoi se operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k ka ofruar cmimin total të ofertës në vlerën 2.880.528 lekë për 12 muaj (pa tvsh), ndërsa operatori ekonomik “Start 2000” sh.p.k ka ofruar cmimin total të ofertës në vlerën 2.880.635,91 lekë për 12 muaj (pa tvsh).

III.1.2. Në shtojcën 1 “Formulari i Ofertës” është kërkuar:

“Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njesia	Sasia	Çmimi Njesi/muaj	Afati
	Shërbimi i ruajtjes se godinës se FSDKSH-se për 1 vend roje me 3 turne.	Muaj			
Çmimi Neto)					
TVSH (%)					
Çmimi Total					

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Sqarime:

1. Ne cmim te jene te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me licensat, uniformat, paisjen me arme dhe radiomarres, pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes ne nje vend roje me tre turne.
2. Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.91 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e kostos mujore të kryerjes së shërbimit.

Analize e kostos

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /muaj	Vlera (Lek) 1 vendroje me tre turne /muaj
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shtesë mbi pagë për turnin III		
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
5	Tarifa për taksë armëmbajtje, municione, mirëmbajtje armatimi, etj.sipas akteve nenligjore		
6	Shpenzime për uniformë dhe veshëmbajtje		
7	Shpenzime për ndërlidhje		
8	Shpenzime të tjera (administrative, etj.)		
9	Fitimi (%)		
	Vlera totale pa tvsh per 1 muaj		
	Vlera totale me tvsh per 1 muaj		

III.1.3. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, është kërkuar:

“Operatorët ekonomike duhet të paraqesin analizën e kostos për ofertën e paraqitur (shih shtojcën 1 –Sqarime).”

III.1.4. Në shtojcën 11 “Termat e referencës” është parashikuar kryerja e shërbimit si vijon:

“Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

“Ruajtja e godinës dhe e ambienteve rrethuese të godinës së institucionit me roje private për vitin 2018”- Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara-me afat 12 muaj.

Kontratat do të lidhen sipas afateve të përcaktuara nga AK.

2.Objektivat:

Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë do të përfshijë sigurimin e ambienteve ku ushtrohet veprimtaria dhe aktiviteti i FSDKSH-së dhe të ambjenteve rrethuese, nga dëmtimet, vjedhjet e mundshme si dhe sigurimin e punës normale të administratës dhe të punonjësve të saj.

Kryerja e shërbimit të jetë 24 orëshe (nga ora 00⁰⁰ deri ne ora 24 ⁰⁰), çdo ditë kalendarike me një vendroje.

Punonjësit e shërbimit duhet:

- Të jenë të pajisur me uniformë me siglën dalluese të shoqërisë, sipas legjislacionit në fuqi dhe me dokument identifikimi personal për çdo punonjës shërbimi.
- Të jenë të pajisur me mjete ndërlidhje për komunikim për të bërë të mundur parandalimin dhe ndalimin e veprimtarisë së keqbërësve në dëm të objektit që ka nën ruajtje.
- Gjatë turneve të dyta dhe të treta të kryejnë kontrolle çdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objektit [...].”

III.1.5. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

III.1.6. Në rastin konkret, shërbimi i kërkuar nga autoriteti kontraktor është llogaritur të kryhet për një periudhë 12 mujore pa ndërprerje, me tre turne, me 4.91 punonjës shërbimi.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në procedurat e prokurimit për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike të objekteve kemi të bëjmë me një shërbim specifik, për të cilin autoriteti kontraktor ka kërkuar preventiv dhe analizë kosto ku të jepen të detajuar elementët apo zërat e domosdoshëm që janë pjesë përbërëse e koston mujore.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik për këtë lloj shërbimi i referohet kontrollit të vlerave minimale ligjore të elementëve të detajuar të ofertës. Nga verifikimi i formularit të ofertës konstatohet se operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k ka deklaruar vlerën mujore të ofertës në shumën 240.044 lekë pa tvsh ose 2.880.528 lekë për 12 muaj (pa tvsh) vlerë kjo që është përcaktuar edhe në renditjen/klasifikimin përfundimtar të ofertave të datës 08.01.2018. Kjo vlerë është e njëjta me atë të ofruar nga operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k në formularin e ofertës dhe në analizën e koston.

Gjithashtu, nga verifikimi i formularit të ofertës konstatohet se operatori ekonomik “Start 2000” sh.p.k ka deklaruar vlerën 2.880.635,91 për 12 muaj (pa tvsh), vlerë kjo që është përcaktuar edhe në renditjen/klasifikimin përfundimtar të ofertave të datës 08.01.2018. Kjo vlerë është e njëjta me atë të ofruar nga operatori ekonomik Start 2000” sh.p.k në formularin e ofertës dhe në analizën e koston.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k qëndron.

Pretendimi i operatorit ekonomik “Start 2000” sh.p.k qëndron.

III.3. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k se: “Oferta ekonomike është nën kosto ligjore”, si dhe pretendimin e operatorit ekonomik “Start 2000” sh.p.k përsa u përket ofertuesve me ofertë më të vogël se ajo e tij, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

III.3.2. Neni 56 i LPP përcakton shprehimisht se: “1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve ose shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve punë shpjegime për elementë të veçantë të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.

III.3.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 5, përcaktohet se: “- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. - Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP”.

III.3.4. Referuar nenin 56 të LPP, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendimin përfundimtar për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, në rast se një apo disa oferta vlerësohen anomalisht të ulëta.

Pra, autoriteti kontraktor dhe konkretisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të tij, ka detyrimin sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik të shqyrtojë dhe vlerësojë ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë në sistemin e prokurimeve elektronike, dhe kualifikon vetëm ofertat të cilat fillimisht plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore, administrative, tekniko – profesionale, ekonomiko – financiare (kriteret kualifikuese) dhe që më pas nuk dalin me ofertë anomalisht të ulët pas

përlllogaritjeve të kryera në përputhje me formulën përkatëse të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe në dokumentat standart të tenderit.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, komisioni i vlerësimit të ofertave të një autoriteti kontraktor, në rastin e procedurës së prokurimit për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të njëjtin detyrim ligjor gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, pra verifikon ofertat që plotësojnë kriteret kualifikuese, e më pas, nuk rezultojnë të jenë anomalisht të ulëta.

III.3.5. Sqarojmë se legjislacioni për prokurimin publik jo më kot ka përcaktuar parashikimin e caktuar në nenin 56 të LPP, pikërisht për të mbrojtur autoritetin kontraktor në rastin e ofertave të papërgjegjshme, duke kryer përlllogaritjet përkatëse dhe evidentimin e ofertave anomalisht të ulëta. Edhe në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët, ligjvënësi ka përcaktuar mënyrën e argumentimit dhe shpjegimit të kësaj oferte nga ana e operatorit ekonomik ankimues duke e dokumentuar, argumentuar me prova shkresore sqarimet për elementin apo elementët e veçantë të ofertës në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Në rast se një ofertë ekonomike, autoritetit kontraktor do t'i rezultojë anomalisht e ulët, atëherë, legjislacioni për prokurimin publik ka përcaktuar mënyrën se si ky i fundit mund të mbrohet nga një ofertë e tillë dhe konkretisht duke i kërkuar operatorit ekonomik, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçantë të ofertës për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Referuar sa më sipër, një autoritet kontraktor ashtu siç vepron në çdo procedurë prokurimi, edhe në rastin e procedurës për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të drejtë që gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të zbatojë parashikimin ligjor në lidhje me ofertën anomalisht të ulët në rast se një ofertë rezulton e tillë.

III.3.6. Nga ana tjetër, në rastin e procedurave të prokurimit për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, nëse një autoritet kontraktor, për shkak edhe të vetë specifikës dhe veçantisë së këtij shërbimi, bazuar në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, ka kërkuar preventive apo analizë kosto, duke përfshirë në të gjithë elementët ligjorë që përbëjnë një kosto mujore duke detajuar zërat apo elementët e veçantë të kësaj kosto, mbi bazën e të cilave autoriteti kontraktor do të gjykojë ofertën e paraqitur, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se do të qëndrojë strikt vendimit të autoritetit kontraktor, mbi bazën e të cilit do të gjykojë më pas, si në rastin kur ka kryer vlerësimin e ofertave duke konkluduar mbi ofertën totale, ashtu

edhe në rastin kur ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto dhe ka bërë vlerësimin e ofertave duke shqyrtuar secilin zë apo element të veçantë të ofertës.

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik, argumenton se ky qëndrim i tij bazohet në qëllimet e ligjit të prokurimit publik për rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore, mirëpërdorimin e fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale; sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Në rast se autoritetet kontraktore do të veprojnë në kundërshtim me sa më sipër, atëherë Komisioni i Prokurimit Publik do t'i rishikojë administrativisht duke i gjykuar ato si të gabuara.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, përfituesi i drejtëpërdrejtë i shërbimit të kërkuar (në këtë rast shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike), është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 62 të LPP “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit organin ose organet, nga të cilët kandidati ose ofertuesi mund të marrë informacionin e duhur për detyrimet fiskale, për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e punonjësve dhe kushtet e punës, që janë në fuqi në Shqipëri ose në rajonin apo nëjzinë vendore ku do të zbatohet kontrata.*

2. Ofertuesit ose kandidatit mund t'i kërkohet të dëshmojë se gjatë hartimit të ofertës i ka marrë parasysh detyrimet, që shoqërojnë zbatimin e kontratës, siç është vendosur nga organet kompetente, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. Detyrimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe kushtet e parashikuara në nenin 46 të këtij ligji janë të vlefshme gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Çdo shmangie nga këto kushte apo detyrime çon në prishjen e kontratës”.

Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ligji i prokurimit publik nuk ka për qëllim që nëpërmjet tij dhe përcaktimeve të tij të kontrollohen një sërë ligjesh të tjera, ashtu siç edhe në rastin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike që një element kryesor është paga minimale, e cila në rastet kur autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto apo kur oferta nuk konstatohet të rezultojë anomalisht e ulët, nuk ka pse të jetë objekt kontrolli edhe nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, pasi ka organe të tjera që merren me kontrollin dhe monitorimin e respektimit të legjislacionit në lidhje me pagën minimale të punonjësve në shkallë vendi.

Në rast se ofertat e kualifikuara nuk rezultojnë anomalisht të ulëta, pas përlogaritjeve përkatëse, apo në rast se rezultojnë të tilla dhe nga autoriteti kontraktor nuk evidentohen shkelje të atij karakteri që të konsiderohen haptazi në kundërshtim me ligjin, të tilla që të ndikojnë në mirëpërdorimin e fondeve publike, si qëllim parësor të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, por bindet me provat dhe argumentat e paraqitura nga operatori ekonomik, atëherë, autoriteti kontraktor duhet të lidhë kontratë me ofertuesin i cili ka paraqitur ofertën më të mirë në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.

III.3.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, në Shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, në pjesën “Sqarim”, autoriteti kontraktor ndër te tjera ka përcaktuar:

1. Ne cmim te jene te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me licensat, uniformat, paisjen me arme dhe radiomarres, pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes ne nje vend roje me tre turne.
2. Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.91 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e kostos mujore të kryerjes së shërbimit.

Analize e kostos

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /muaj	Vlera (Lek) 1 vendroje me tre turne /muaj
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shtesë mbi pagë për turnin III		
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
5	Tarifa për taksë armëmbajtje, municione, mirëmbajtje armatimi, etj.sipas akteve nenligjore		
6	Shpenzime për uniformë dhe veshëmbathje		
7	Shpenzime për ndërlidhje		
8	Shpenzime të tjera (administrative, etj.)		
9	Fitimi (%)		
	Vlera totale pa tvsh per 1 muaj		
	Vlera totale me tvsh per 1 muaj		

III.3.9. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, është kërkuar: _____

“Operatorët ekonomike duhet të paraqesin analizën e kostos për ofertën e paraqitur (shih shtojcën 1 –Sqarime).”

III.3.10. Në shtojcën 11 “Termat e referencës” është parashikuar kryerja e shërbimit si vijon:

“Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

“Ruajtja e godinës dhe e ambienteve rrethuese të godinës së institucionit me roje private për vitin 2018”- Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara-me afat 12 muaj.

Kontratat do të lidhen sipas afateve të përcaktuara nga AK.

2.Objektivat:

Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë do të përfshijë sigurimin e ambienteve ku ushtrohet veprimtaria dhe aktiviteti i FSDKSH-së dhe të ambjenteve rrethuese, nga dëmtimet, vjedhjet e mundshme si dhe sigurimin e punës normale të administratës dhe të punonjësve të saj.

Kryerja e shërbimit të jetë 24 orëshe (nga ora 00⁰⁰ deri ne ora 24 ⁰⁰), çdo ditë kalendarike me një vendroje.

Punonjësit e shërbimit duhet:

- *Të jenë të pajisur me uniformë me siglën dalluese të shoqërisë, sipas legjislacionit në fuqi dhe me dokument identifikimi personal për çdo punonjës shërbimi.*
- *Të jenë të pajisur me mjete ndërlidhje për komunikim për të bërë të mundur parandalimin dhe ndalimin e veprimtarisë së keqbërësve në dëm të objektit që ka nën ruajtje.*
- *Gjatë turneve të dyta dhe të treta të kryejnë kontrolle çdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objektit [...].”*

III.3.11. Komisioni vëren se operatorët ekonomikë pjesmarrës në këtë procedure prokurimi, kanë paraqitur ofertat e tyre ekonomike bazuar në analizën e kostos mujore të kryerjes së shërbimit, përkatësisht për 1 roje /muaj, si dhe për 1 vendroje me tre turne/muaj- në përputhje me dokumentat e tenderit. Renditja e ofertave të operatorëve ekonomikë nga KVO është kryer mbi bazën e analizës së kostos mujore të kryerjes së shërbimit për 12 muaj.

III.3.12. Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur nga ankimuesi, dokumentacionin e dorëzuar nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë dhe konkretisht elementëve bazë (pagë bazë, shtesa mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore në masën 16,7%) – elementë këta të cilat janë përcaktuar shprehimisht dhe në DST-; gjykon se operatori ekonomik ankimues “Eurogjici Security” sh.p.k nuk ka respektuar dispozitat ligjore për shtesat mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe detyrimet ligjore për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në masën 16.7%.

Komisioni sqaron se ka qënë detyrë e operatorit ekonomik që të garantojë që oferta e paraqitur prej tij të përfshijë të gjithë elementët e kërkuar nga AK me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Në rastin në fjalë, operatori ekonomik ankimues i lartpërmendur nuk ka përmbushur detyrimet bazë për një ofertues, përse i përket shtesave mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, në masën dhe vlerat e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi prandaj dhe oferta e tij ekonomike rezulton të jenë nën minimumin e lejuar ligjor të këtij shërbimi.

Në sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k nuk qëndrojnë.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik, pasi mori në shqyrtim ofertat ekonomike të të gjithë operatorëve ekonomikë të kualifikuar, të cilët kanë paraqitur ofertë me vlerë më të ulët se ajo e operatorit ekonomik “Start 2000” sh.p.k. Nga ky shqyrtim konstatohet se ofertat e operatorëve ekonomikë “Nazeri 2000” sh.p.k, “Ales” sh.p.k , “Oktapus” sh.p.k, “SSX”sh.p.k, “International Security Albania” sh.p.k, “Oktapus 1 Security” sh.p.k dhe “Aulona Pol 1” sh.p.k, rezultojnë të jenë nën minimumin e lejuar ligjor të këtij shërbimi.

Pretendimet e operatorit ekonomik “Start 2000” sh.p.k qëndrojnë

III.4. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Klaron” sh.p.k se: “Gjatë vlerësimit të kontratave të paraqitura nga subjekti ankimues, konstatohet se këto kontrata nuk përmbushin vlerën prej 40% të fondit limit të kontratës sic është specifikuar në kriterin e mësipërm për kualifikim.

Duhet theksuar se faturat tatimore të shitjes së shërbimit me subjektet private nuk i janë bashkëlidhur kontratat përkatëse sic është kërkuar specifikisht në kriterin e mësipërm për kualifikim dhe për pasojë

nuk mund të merren parasysh në përlogaritjen e vlerës prej 40% të fondit limit të kontratës. [...] Sqarojme se në momentin kur keto kritere për kualifikim nuk janë ankimuar, në përputhje me procedurat ligjore në fuqi, konsiderohen si të mirëqëna nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe duhen plotësuar si të tilla”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 6 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës si vijon:

“Furnizime të mëparshme të së njëjtës natyrë në një kontratë me vlerë jo më të ulët se 40% e fondit limit të kontratës, (në një vlerë jo më të ulët se (1,218,403.44) lekë furnizimi të jetë i realizuar gjatë 3 viteve të fundit (2015, 2016, 2017) të aktivitetit të operatorit ekonomik.

Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a. Kur kontrata e së njëjtës natyrë është realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin ,të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate.

OSE

- b. Kur kontrata e së njëjtës natyrë është realizuar me subjekte private, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me subjektin privat, të shoqëruar me faturat përkatëse tatimore të shitjes që mbulojnë vlerën e kontratës.”

III.4.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në tender nga ana e operatorit ekonomik “Klaron” sh.p.k, rezulton se për plotësimin e kërkesës për përvojën e mëparshme, është dorëzuar si vijon:

1. Kontratë datë 27.02.2015, lidhur ndërmjet Komsionit të Prokurimit Publik dhe operatorit ekonomik “Klaron” sh.p.k me objekt: “*Ruajtja me polici private*” dhe vlerë 445.975 lekë pa tvsh. Kjo kontratë është shoqëruar me vërtetimin e realizimit me sukses të kontratës me nr.131 prot., datë 02.02.2016.
2. Kontratë datë 15.09.2015, lidhur ndërmjet Arkimvit Qëndror Shtetëror të Filmit dhe operatorit ekonomik “Klaron” sh.p.k me objekt: “*Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të Arkivit Qëndror Shtetëror të Filmit*” dhe vlerë 582.719 lekë pa tvsh. Kjo kontratë është shoqëruar me vërtetimin e realizimit me sukses të kontratës me datë 11.12.2015.
3. Faturë Tatimore Shitje, nr.52 datë 28.02.2017 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat me vlerë 125.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit “*Ruajtje objekti me roje private dhe sistem alarmi*”.
4. Faturë Tatimore Shitje, nr.06, datë 31.01.2017 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 125.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit “*Ruajtje objekti me roje private dhe sisetm alarmi*”.
5. Faturë Tatimore Shitje, nr.94, datë 31.03.2017 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 125.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit “*Ruajtje objekti me roje private dhe sisetm alarmi*”.

6. Faturë Tatimore Shitje, nr.531, datë 31.07.2016 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 125.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje private dhe sisetm alarmi”*.
7. Faturë Tatimore Shitje, nr.569, datë 31.08.2016 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 125.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje private dhe sisetm alarmi”*.
8. Faturë Tatimore Shitje, nr.683, datë 31.11.2016 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 125.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje private dhe sisetm alarmi”*.
9. Faturë Tatimore Shitje, nr.01, datë 10.01.2017 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 160.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje fizike”*.
10. Faturë Tatimore Shitje, nr.89, datë 10.03.2017 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 160.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje fizike”*.
11. Faturë Tatimore Shitje, nr.170, datë 30.04.2017 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 160.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje fizike”*.
12. Faturë Tatimore Shitje, nr.627, datë 10.10.2016 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 160.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje fizike”*.
13. Faturë Tatimore Shitje, nr.674, datë 10.11.2016 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 160.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje fizike”*.
14. Faturë Tatimore Shitje, nr.508, datë 10.07.2016 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 160.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje fizike”*.
15. Faturë Tatimore Shitje, nr.134, datë 10.04.2017 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 160.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje fizike”*.
16. Faturë Tatimore Shitje, nr.725, datë 10.12.2016 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 160.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje fizike”*.
17. Faturë Tatimore Shitje, nr.545, datë 10.8.2016 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 160.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje fizike”*.
18. Faturë Tatimore Shitje, nr.583, datë 10.09.2016 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 160.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje fizike”*.
19. Faturë Tatimore Shitje, nr.68, datë 28.02.2017 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 266.665 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje private dhe sinjal alarmi”*.

20. Faturë Tatimore Shitje, nr.19, datë 31.01.2017 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 210.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje private”*.
21. Faturë Tatimore Shitje, nr.113, datë 31.03.2017 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 310.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje private”*.
22. Faturë Tatimore Shitje, nr.659, datë 31.10.2017 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 210.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje private dhe sinjal alarmi”*.
23. Faturë Tatimore Shitje, nr.699, datë 30.11.2016 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 210.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje private dhe sinjal alarmi”*.
24. Faturë Tatimore Shitje, nr.174, datë 30.04.2017 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 310.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje private dhe sinjal alarmi”*.
25. Faturë Tatimore Shitje, nr.746, datë 30.12.2016 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 210.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje fizike”*.
26. Faturë Tatimore Shitje, nr.534, datë 31.07.2016 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 320.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje fizike”*.
27. Faturë Tatimore Shitje, nr.767, datë 31.12.2016 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 160.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje fizike”*.
28. Faturë Tatimore Shitje, nr.723, datë 30.11.2016 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 160.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje fizike”*.
29. Faturë Tatimore Shitje, nr.675, datë 10.11.2016 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 50.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje fizike”*.
30. Faturë Tatimore Shitje, nr.568, datë 31.08.2016 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 320.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje fizike”*.
31. Faturë Tatimore Shitje, nr.624, datë 30.08.2016 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 320.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje fizike”*.
32. Faturë Tatimore Shitje, nr.665, datë 31.10.2016 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 320.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje fizike”*.
33. Faturë Tatimore Shitje, nr.711, datë 30.11.2016 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 480.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje fizike”*.

34. Faturë Tatimore Shitje, nr.765, datë 31.12.2016 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 480.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje fizike”*.
35. Faturë Tatimore Shitje, nr.635, datë 31.10.2016 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 480.000 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje fizike”*.
36. Faturë Tatimore Shitje, nr.02, datë 11.01.2017 me shitës shoqërinë “Klaron” për një subjekt juridik privat, me vlerë 53.335 lekë pa TVSH me përshkrim të shërbimit *“Ruajtje objekti me roje fizike”*.

III.4.3. Në nenin 46 pika 1 gërna “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, të ndryshuar parashikohet se:

“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

III.4.4. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.4.5. Në nenin 28 , pika 3 *“Kontratat e Shërbimeve”* të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, të ndryshuar, parashikohet se *“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”*

Në Dokumentat Standarte të Tenderit, pika II, *“Udhëzime për operatorët ekonomikë”*, Seksioni 1 *“Hartimi i ofertës”*, pika 1.1, thuhet: *“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”*.

III.4.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike,

financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

III.4.7. Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "Klaron" shpk për eksperiencat e mëparshme, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, dokumentacioni i paraqitur për kontratat e lidhura me subjekte shtetërore është i rregullt pasi është shoqëruar me vërtetimet e realizimit, konform kërkesës së autoritetit kontraktor, ndërsa faturat tatimore të paraqitura për shërbimet e kryera ndaj subjekteve private nuk janë shoqëruar me kontratat përkatëse në kundërshtim me kërkesën e autoritetit kontraktor sikurse është specifikuar në kriteret e vecanta të kualifikimit si më sipër cituar.

Në sa më sipër, si dhe duke patur parasysh kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues "Klaron" shpk ka dështuar të përmbushë kërkesën e autoritetit kontraktor për të paraqitur dokumentacionin e nevojshëm, për eksperiencat e mëparshme të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të shoqërisë, pasi dy kontratat e lidhura me autoritetet kontraktore me vlerë totale 1.028.694 lekë pa tvsh, nuk plotësojnë shumën e kërkuar prej 1.218.403,88 lekë që përbën 40% të fondit limit, ndërsa për shërbimet e kryera me sektorin privat, faturat tatimore të shitjes nuk janë shoqëruar me kontratat e lidhura me këto subjekte sic është kërkuar nga autoritetit kontraktor, citojmë: *"Kur kontrata e së njëjtës natyrë është realizuar me subjekte private, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me subjektin privat, të shoqëruar me faturat përkatëse tatimore të shitjes që mbulojnë vlerën e kontratës."*

K.P.P. gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar parashikohet se *"Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni"*. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643

datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet mbi arsyet e tjera të skualifikimit të operatorit ekonomik “Klaron” shpk, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar arsyetimit të dhënë më sipër në pikën III.4. gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron, operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriterin e veçantë të pranimit/kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike edhe pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk do të ndryshojë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Public Health Sector

Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Start 2000” sh.p.k vetëm për pretendimet për kualifikimin e tij në procedurën e prokurimit “Marrëveshje kuadër”, me Nr. Ref-36750-12-06-2017, me objekt: “Ruajtja e godinës dhe e ambienteve rrethuese të godinës së institucionit me roje private për vitin 2018”, me fond limit 3.046.008,6 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27.12.2017, nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshem të Kujdesit Shendetesor Tiranë.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Eurogjici Security” shpk për procedurën e prokurimit të lartpërmendur.
3. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Klaron” shpk për procedurën e prokurimit të lartpërmendur
4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Start 2000” sh.p.k dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë ofertues.

5. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Nazeri 2000” sh.p.k, “Ales” sh.p.k , “Oktapus” sh.p.k, “SSX”sh.p.k, “International Security Albania” sh.p.k, “Oktapus 1 Security” sh.p.k dhe “Aulona Pol 1” sh.p.k dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke i skualifikuar këta ofertues.
6. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
7. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Start 2000” sh.p.k” sh.p.k.
8. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 100 Protokolli;
Datë 24.01.2018

Nr. 127 Protokolli;
Datë 26.01.2018

Nr. 137 Protokolli
Datë 29.01.2018

